



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	02.06	2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKUMSHICK	2797/2021		114	

Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.370/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional-procesmbajtëse, sipas Aktgjykimit A.nr.2438/19 të datës 27.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokollit 3311/2019 të datës 29.07.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi fshati "Smirë"Viti, kundër organit të punësimit- Komuna e Vitisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ,, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 02.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.433/2019 e datës 29.07.2019 e parashtruar nga ankuesi

II.Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 67/2018 i datës 01.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Vitisë.

A r s y e t i m

Komuna e Vitisë, me datë 26.04.2019 ka shpallur konkursin me nr.02-111/01-436 për pozitën Inspektor i Mjedisit në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi Me datën 24.05.2019 Komuna e Vitisë ka nxjerre njoftimin me nr.02-016/01-563 për kandidatët e suksesshëm.

I pakënaqur me njoftimin e datës 24.05.2019, ankuesi më datë 03.06.2019 ka parashtruar ankesë me nr.02-320/04-26389 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Vitisë. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Vitisë më datë 01.07.2019 nxjerr Vendimin me Nr.67/2019 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit Nr.67/19 të datës 01.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Vitisë, më datë 29.07.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3311/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.07.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vitisë. Komuna e Vitisë më datë 06.08.2019 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e procedurës së zhvilluar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3311/2019 të datës 29.07.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit i datës 26.04.2019 me nr.02-111/01-436; Ankesë e datës 03.06.2019 me nr.02-320/04-26389 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Vitisë; Vendimi i datës 01.07.2019 me nr.67/2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Vitisë; Diplomë me numër nr.53 i datës 01.07.2002 e lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë; Vërtetim i datës 13.10.2017 me nr.496 e lëshuar nga Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës" në Viti; Vërtetim i datës 15.10.2015 me nr.protokoll 112/15 i lëshuar nga SHFMU "Dëshmorët e 5 Prillit" Smirë; Certifikatë e MASHT-GIZ; Certifikatë e datës 04.10.2011; Certifikatë e datës 11.03.2010; Certifikatë e datës 21.12.2010; Certifikatë e datës 24.11.2010; Certifikatë e datës 13.02.2005; Certifikatë e datës 16.11.2012; Certifikatë e datës 13.09.2004; Përgjigje në Ankesë i datës 06.08.2019; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 30.07.2019; Kërkesa për punësim e datës 08.05.2019 për bashkë me dokumentet e kërkuara; Vendim i datës 15.05.2019 me nr.02-035/02-531; Autorizimi i MAP-it i datës 24.04.2019; Formulari MAP-SHCK-09; Njoftim i datës 24.05.2019 për kandidatin e suksesshëm; Lista e ngushtë e datës 16.05.2019; Kërkesë për miratim i datës 23.05.2019 për formimin e Komisionit Përzgjedhës; Kërkesa për punësim e datës 07.05.2019 për bashkë me dokumentet e kërkuar dhe Përgjigje në ankesë e datës 06.08.2019 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Komuna e Vitisë zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën " Inspektor i Mjedisit " në Drejtorinë për Inspektion është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se kriteret themelore të konkursit për këtë pozitë kanë qenë:

- *Diplome Universitare –Biologji, Kimi ose Bujqësi;*
- *Tri (3) vite përvojë pune e dëshmuar me kontrata, trust"*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Komuna e Vitisë procedurën e rekrutimit për pozitën " Inspektor i Mjedisit" " e ka zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të

Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sepse ka ndryshuar kriteret e konkursit, sepse në Autorizimin e MAP/DASHC i aprovuar me 24.04.2019 ka përcaktuar kriteret e konkursit për pozitën “Inspektor i Mjedisit” *Diplome Universitare –Biologji, Kimi ose Bujqësi dhe tri (3) vite përvojë pune*”, ndërsa Komuna e Vitisë më datë 26.04.2019 ka shpallur konkursin për pozitën “Inspektor i Mjedisit” në Drejtorinë e Inspektionit me kriteret e konkursit si: **“Diplomë universitare:Biologji, Kimi ose Bujqësi dhe Përvoja e punës 3(tri)vite e dëshmuar me kontrata, trust”**, mbi këtë bazë ankuesi pretendon që Komuna e Vitisë ka ndryshuar kriteret e konkursit në krahasim me ato të aprovuara nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, rrjedhimisht Komuna e Vitisë gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën “Inspektor i Mjedisit”, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e 16 paragrafit 1 nënparagrafit 1.8 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe me nenin 14 paragrafin 2 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil e cila përcakton se **“Miratimi nga DASHC/MAP përfshinë edhe autorizimin për publikimin e shpalljes së rekrutimit”**, që nënkupton se nuk mund të bëhet asnjë ndryshim i kriterëve të konkursit pa miratimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike nga ai që është aprovuar në autorizim nga vetë Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, në këtë rast konsiderohet që procedura është e pavlefshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ky pretendim i ankuesit është i paqëndrueshëm sepse në këtë rast nuk janë ndryshuar kriteret e konkursit sepse Komuna e Vitisë ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 16 paragrafit 1 nënparagrafit 1.8 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili *specifikon* **“kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja paraprake e punës”** e në këtë rast nuk janë ndryshuar as kualifikimi arsimor e as përvoja e punës.

Pretendim tjetër ankimor i ankuesit ka qenë se kandidati i cili është përzgjedhur nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se KPSHC me rastin e përzgjedhjes së kandidatit të suksesshëm për pozitën “Inspektor i Mjedisit” në Komunën e Vitisë, si kandidat i cili ka grumbulluar me se shumti pikë 74.6%, ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **“Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”**. Kandidati i përzgjedhur z. posedon Diplomën e datës 01.06.1998 Inxhinier i diplomuar i Bujqësisë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, dhe sipas vërtetimit të datës 07.05.2019 ka këtë përvojë pune prej datës 27.11.1991 deri më datën 23.03.1999 në pozitën drejtor në ndërrmarjen N.T.P“Liria” në Sadovinë të Jerlive.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të të gjitha provave të lëndës ka konstatuar që Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Komunës së Vitisë, procedurën e rekrutimit për pozitën “Inspektor i Mjedisit” e ka zhvilluar në pajtim me nenin 11 paragrafin 1, nenin 13 paragrafin 1 dhe 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **11.1”Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.13.1 “Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësitë fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse” dhe neni 18.1 i cili përcakton “Pranimi në Shërbimin Civil**



mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës’’. Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se KPSHC ka vepruar në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri në tetor 2020, ku më datë 08.10.2020 janë zgjedhë 5 anëtar të këshillit ndërsa më datë 14/10/2021 janë themeluar edhe kolegjet profesionale, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 05.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Vitisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 67/2018 i datës 01.07.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.370/2021, datë 02.06.2021

Sabile AVDYLI
Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankueses,
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative - Kreshnik Kaçiu;
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vitisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

